Etika për fëmijë

Dhuratë e përmuajshme, nga revista "Etika"

Viti 4 - Numri 46 - Tetor 2014

Foleja me ëndrra zogu...

Emocioni i shkollës

Hakan Gyltekin

Që prej shumë kohësh, Aisa po përjetonte emocionin e fillimit të shkollës. Vallë, çfarë shoqesh do të kishte, a do ta donin ato, a do ta vlerësonte mësuesi?.. Kishte disa ditë që nuk flinte mirë për 'faj' të këtyre mendimeve...

Në fillim ishte vetëm një emocion i bukur por me kalimin e kohës u shndërrua në frikë të mirëfilltë. Filloi t'i mbushej mendja që shoqet nuk do ta donin ose ajo do të bënte ndonjë gabim që ditën e parë dhe do të turpërohej para të gjithëve. Kishte krijuar me qindra skenarë të çuditshëm, nganjëherë edhe të frikshëm... Tani nuk donte të shkonte më në shkollë.

Pastaj... çfarë do të bënte në shkollë? Më mirë të rrinte në shtëpi dhe të luante me kukullat... Do t'u qepte rroba të ndryshme atyre. Më pas do të dilte jashtë për të luajtur me shoqet e lagjes. Do të luanin kukafshehtas, me top, me litar dhe shumë lojëra të tjera argëtuese.

Nesër ishte dita e parë e shkollës. Aisa ishte e vendosur që të mos shkonte. Tashmë ajo mund të flinte e qetë, e liruar nga mendimet që e kishin lodhur për një kohë aq të gjatë. Vendosi kokën në jastëk dhe e zuri gjumi menjëherë.

Ajo e kishte menduar aq shumë ditën e parë të shkollës saqë tani i qe bërë pjesë e ëndrrave. Në ëndrrën e asaj nate shikoi shoqet e saj që kishin zënë shumë shoqe të reja. Ndërsa Aisa ishte në shtëpi duke luajtur me kukullat. Dilte jashtë por nuk gjente askënd, sepse të gjitha shoqet ishin në shkollë. Gjatë paradites mërzitej shumë në shtëpi dhe mezi priste ardhjen e mbrëmjes për t'u takuar me shoqet që ktheheshin nga shkolla.

Shoqja më e ngushtë e Aisës, Medina, kishte filluar shkollën. Në një kohë të shkurtër ajo kishte mësuar shkrim dhe lexim. Tani ishte në gjendje të lexonte tabelat në rrugë, shkrimet tek lojërat dhe çdo gjë tjetër. Aisa e shikonte me zili, sepse ajo nuk i dinte ato gjëra...

Duke qenë se Aisa nuk kishte shkuar në

shkollë, nëna nuk i kishte blerë çantë, fletore, libra e lapsa, si dhe mjete të tjera shkollore. E çfarë i duhej, ku do t'i përdorte? Aisa ishte aq e mërzitur sa shkoi tek nëna dhe me lot në sy iu lut që ta çonte në shkollë. Teksa po i përgjërohej me ngashërim, i doli gjumi...

Kishte ardhur dita e madhe, dita e parë e shkollës. Tashmë Aisa, pas asaj ëndrre, mezi po priste të shkonte në shkollë. Veshi përparësen e bardhë, mori çantën dhe u nis për në shkollë. Hyri në klasë dhe u ul në bankë. Krejt ashtu si e kishte shikuar në ëndërr, i ndodhi diçka e papritur. Libri i ra nga dora dhe zuri vend poshtë bankës, në një cep. Por vazhdimi i ngjarjes nuk ngjasonte aspak me atë të ëndrrës. Shoqja e bankës, Fatma, e ndihmoi që të merrte librin dhe ato u bënë shoqe menjëherë. Por shpejt Aisa zuri dhe shoqe të tjera. Sa të dashura ishin me të!.. Bile, sikletin e rënies së librit ia hoqi menjëherë mësuesja me ëmbëlsinë e saj. Aisa, këto, as që i kishte menduar... Por, ja që shkolla të rrethon me dashurinë e saj...

Dita e parë e shkollës i kaloi shumë bukur saqë ajo do të donte të mos kishte përfunduar kurrë... Tani dëshironte të mësonte sa më shpejt shkrimin në mënyrë që të shënonte kujtimet e kësaj dite kaq të veçantë.

Etika për fëmijë

Drejtor
Albert Halili
+355 67 60 78484

Kryeredaktor:
Alban Kali
+355 69 24 23989

Redaktor:
Xhahid Bushati
xhahidbushati@yahoo.com
+355 69 28 20 975

Redaktor gjuhësore:
Zija Vukaj

Përkthyes:
Ernida Kraja
Naile Sulaj

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Adresa: L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633
Zyra e përfaqësimit Maqedoni: Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271
Zyra e përfaqësimit Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795

ÇLIRIMI I MEKËS

Hajredin Ekmen

Në vitin 630 Mushrikët e Mekës e prishën marrëveshjen e Hudejbijes që bënë me Pejgamberin (a.s.). Për këtë arsye, Pejgamberi përgatiti një ushtri të madhe dhe u nis të çlironte Mekën. Ndërsa po përparonin drejt Mekës, në sajë të muxhahidëve që vinin gjatë rrugës dhe bashkoheshin me ushtrinë islame, kjo e fundit arriti në dhjetë mijë ushtarë.





Pastaj u bëri të ditur sigurinë që Pejgamberi dha për ta. Mushrikët nuk ishin as të fuqishëm dhe as të përgatitur për t'u përballur me ushtrinë Islame. Të gjithë pranuan të dorëzoheshin përveç një grupi që udhëhiqej nga Ikrime bin Ebi Xhehl.



Ndërkohë në Mekë po përjetohej frikë dhe shqetësim. Ushtrinë Islame e kishte përfshirë një gëzim i papërshkrueshëm. Pejgamberi (a.s.) e përgatiti ushtrinë në të katër anët për të hyrë në qytet.

Më pas ushtria Islame hyri në Mekë nga të katër anët. Pejgamberi (s.a.s.) qëndronte hipur mbi devenë e Tij, Kasvanë. Në kokë mbante një shall të zi. Ai falenderonte pa pushim Allahun, që i kishte mundësuar një çlirim të tillë dhe këndonte suren "Fet'h".



Ndërsa ushtria po hynte me qetësi në qytet, në anën e ushtrisë të cilën e komandonte Hz. Halid bin Velidi, ndodhi një sulm.

Një grup i nxitur nga Ikrime bin Ebi Xhehl dhe Safvan bin Umejje filluan të lëshonin shigjeta drejt ushtrisë, kështu filloi një përleshje. Gjatë kësaj përleshjeje dy sahabë ranë dëshmorë. Ndërsa në anën e mushrikëve u vranë trembëdhjetë prej tyre. Të tjerët që ngelën, ia mbathën. Përveç kësaj nuk pati asnjë konflikt tjetër.

Pas çlirimit, Pejgamberi (a.s.) bashkë me sahabët e nderuar bënë tavaf Qaben. Poashtu fali dy rekatë namaz në Makam-i Ibrahim. Më pas hyri brenda në Qabe dhe lexoi ajetin 81 të sures Isra.





Kështu Pejgamberi (a.s.), shpalli falje publike. Ky veprim mëshire i të Dërguarit të Allahut (a.s.), ndikoi thellësisht te mekasit. Kurejshët e Mekës u penduan me zemër për ato që kishin bërë dhe në një kohë të shkurtër të gjithë u bënë myslimanë.

Xhahid Bushati

Foleja me ëndrra zogu

Si çdo natë
një hënë, një yll
mysafirë
erdhën në pyll...

U tha pylli:
'S'dua zhurmë!
Në fole
një ëndërr humb...



Se një ditë
një zog me emër
ngriti çerdhen
dhe një ëndërr...'

* * *

Hëna, ylli
falën ëndrra,
e kush dritat
s'i ka ënda?..

Ilustrimet: Eris Bushati

Ismail Alogllu

SALMONI

Peshku që noton kilometra të tërë në drejtim të kundërt të rrjedhës

Salmoni është një peshk që rritet në ujëra të ëmbla, emigron në det dhe më vonë kthehet sërish në ujërat e ëmbla për të lëshuar vezët e tij. I lëshon vezët në vjeshtë në ujërat e rrjedhshme dhe në fund të dimrit vezët çelin. Poshtë barkut të secilit nga peshqit e vegjël gjendet një qese me të verdhën e vezës, e cila përmban ushqimin e duhur për hapat e parë të zhvillimit.

Sapo lindin dhe në ditët e para të jetës peshqit fshihen nëpër gurë e zhavorr dhe mbrohen nga kafshët grabitqare derisa të konsumojnë plotësisht qesen poshtë barkut. Të vegjlit e salmonit rozë, sapo dalin nga veza, nisen drejt detit. Ndërsa peshqit e rinj salmonë, emigrimin e parë të jetës së tyre e bëjnë duke 'ecur' në rrjedhat e lumenjve. Gjatë këtij udhëtimi drejt detit ata përballen me rreziqe të ndryshme, si: ujëvara, ujëra të zeza dhe peshq më të mëdhenj apo grabitqarë të tjerë që mundohen t'i hanë. E plotësojnë këtë emigrim vetëm ata që i kalojnë me sukses këto rreziqe dhe dalin në det të hapur. Pasi qëndrojnë disa vite në dete, rriten dhe arrijnë kohën e riprodhimit, ata nisin sërish një emigrim të ri. Në shtratin e lumit, gjatë të cilit notuan vite më parë për të arritur në det, tashmë do të notojnë krejt mbrapsht, pra, në anën e kundërt të rrjedhës. Vendi të cilin synon salmoni të arrijë pas këtij udhëtimi, është pikërisht vendi ku ai doli nga veza, vendi ku erdhi në jetë. Kjo për arsye se peshqit zgjedhin për të lëshuar vezët burimin ku ata lindën edhe vetë.



Salmonët e Atlantikut e përsërisin emigrimin çdo vit. Ndërsa salmonët e tjerë emigrojnë vetëm një herë në jetën e tyre. Është e habitshme distanca rrugore që ata marrin përsipër të bëjnë. Salmonët që duan të dalin në det të hapur, për t'ia arritur këtij qëllimi, duhet të notojnë mijëra kilometra. Për shembull: një peshkaqen



salmon që i lëshon vezët në vjeshtë, noton më shumë se 3200 kilometra. Një salmon i kuq noton në një distancë më të madhe se 1600 kilometra. Gjithashtu ata arrijnë ta planifikojnë kohën e periudhës së lëshimit të vezëve, kur kanë për të bërë rrugë të gjatë. Para se të bëjnë këtë emigrim kaq të lodhshëm, ata depozitojnë shumë energji.

Salmonët në udhëtimin që nga vendi ku lindën e përgjatë ujërave të rrjedhshme, duhet të gjejnë ngushticën (grykën) që të nxjerr në det, sepse ajo do të jetë rrjedha që do të jetë edhe në rrugën e kthimit. Asnjë salmon nuk gabon në këtë çështje. Ai e gjen menjëherë grykën e burimit, nga e cila njëherë e një kohë doli në det. Pasi hyn në rrjedhën e lumit, salmoni fillon të notojë në të kundërt të rrjedhës. Për t'ia arritur qëllimit, salmoni e përballon me gjithë fuqinë që ka forcën e rrjedhës së lumit dhe i kapërcen ujëvarat duke u hedhur përafërsisht katër metra mbi sipërfaqen e ujit. Salmoni është i detyruar të drejtohet drejt ndarjes së të dy krahëve të lumit për të arritur në të njëjtin vend ku erdhi në jetë, në cilindo krah ku ndodhet burimi dhe sado thellë të jetë ai. Salmonët e gjejnë shumë lehtë rrugën në të cilën mund të kenë kaluar vetëm një herë në jetën e tyre. Ata devijojnë gjithmonë në rrjedhën e lumit që i çon në vendlindje. Gjatë kësaj kohe nuk ushqehen aspak.

Për të përcaktuar drejtimin e tyre, ata përdorin shqisën e të nuhaturit. Secila rrjedhë për ta ka një aromë që i karakterizon. Gjatë udhëtimit të tij të parë drejt detit, salmoni i ri memorizon të gjitha aromat e rrjedhave. Në rrugën e kthimit e gjen vendin e duhur me ndihmën e këtyre aromave.

Po pse nisen salmonët në një udhëtim kaq të gjatë e të vështirë? Pse nuk i lëshojnë vezët e tyre në det ose në fillim të rrjedhave, por brenda në lumenj mijëra kilometra larg detit? Si e gjejnë vendsynimin pa e humbur aspak drejtimin? Si arrijnë ta planifikojnë kohën në mënyrë kaq perfekte? Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe mësimi që duhet të marrim nga këta peshq është mjaft i qartë. Në ekuilibrin e përsosur ekologjik që Allahu Teala ka krijuar, janë planifikuar hollësisht të gjitha detajet.

MEMISHXHANI

Ekrem Bektash

GOJËN MOS E HAP DHE DO TË TË RESPEKTOJNË, FOL ME SY SE MË MIRË TË TË KUPTOJNË...

Të dashur miq,

A jeni shumë llafazanë?.. E di, nuk e prisnit një pyetje të tillë. Mos harroni që njeriu duhet të jetë i përgatitur edhe për gjëra të papritura. Nëse do t'jua përsëris këtë pyetje jam i sigurt që do të përgjigjeni kështu: "Jo unë nuk jam llafazan!"

Mundet... Nuk po ju akuzon kush. Mua më quajnë llafazan. Pse vallë?.. Sipas njerëzve unë flas shumë. Aq shumë flas saqë nuk mjaftojnë këto faqe për t'i përmbledhur të gjitha fjalët e mia. Atëherë unë po e përfundoj fjalën time dhe njerëzit të kullosin gomarët në pjesën bosh të faqes... Por nuk mund të duroj pa folur!..

Edhe mësuesi më thotë shpesh: "Memishxhan, ti flet shumë!"

Mësuesi ka të drejtë por babai më ka sjellë në shkollë për të mësuar se si të flas. Në qoftë se do të ma presin fjalën një e dy, si mund të përparoj unë?

-Mos fol gjëra të parëndësishme!

Mbase ato që për ju janë të parëndësishme, për mua janë shumë të rëndësishme.

-Mos fol gjatë mësimit!

Sa keq që mua më vjen frymëzimi vetëm në mësim. Në pushim luaj aq shumë sa nuk gjej kohë për të folur?

-Fol pak e saktë!

Ajo është punë e vështirë! Njeriu që nuk e shpjegon hallin e vet me shumë fjalë, si mund ta shpjegojë me pak fjalë?

-Të parët tanë ia kanë arritur t'i shpjegojnë gjërat me pak fjalë!

Hee! E drejtë! Unë harxhoj faqe të tëra për të shpjeguar mendimet e mia dhe nuk ia dal dot. Tani e tutje le të flasim vetëm me proverba. Shkurt e saktë... Nuk e di se çfarë do të bëj me kohën që tepron.

NËSE FLET DIKUSH TJETËR, UNË Ç'FAJ KAM, NUK E PUSHOJ DOT SE I PAFUQISHËM JAM...

Tani le të kthehemi tek të folurit me pak fjalë, pra tek fjalët e urta...

Ju të gjithë e njihni meksikanin Myzo. Nëse nuk e njihni, pyesni ato që e njohin. Myzoja ynë, pra Myzaferi fle gjatë gjithë kohës prandaj ne e quajmë meksikan... Meksikani Myzo si çdo meksikan fle sa herë që i jepet rasti.

Sa e vendos kokën në tavolinë e kaplon një gjumë i rëndë dhe nuk zgjohet edhe nëse bien topa. Nuk e zgjon asgjë. Bile unë një ditë i thashë mësuesit: "Le të sjellim një jastëk në klasë dhe t'i shpëtojë koka Myzos nga kjo dërrasë e fortë."

Mësuesi m'u përgjigj:

-Nuk bën! Nëse marrim jastëk, do të na kërkoj edhe batanije e jorgan...

Kaloi pak kohë dhe Myzoja filloi të mos flinte më në klasë në sajë të përpjekjeve të mia. Por tani mësuesi filloi të zemërohej me mua:

-Mos e bëj Myzaferin që të flasë!

Unë jam llafazan pra!.. E paskam bërë dhe Myzaferin si veten, llafazan. Sigurisht që ky është vetëm mendimi i mësuesit tonë:

Myzaferi është ulur pranë meje prandaj është bërë ashtu.

VALLË SI DO TE BËHET HALLI JONË, KUSH DO MERRET ME EDUKATËN TONË?

Tani le të kthehemi tek gabimi që bëri mësuesi... Teksa Myzoja flinte mbi bankat e forta të shkollës mësuesi ynë më bëri një kërkesë:

-Mbaje zgjuar Myzaferin! Mos e lejo që të flejë!

Mësuesi kishte shumë të drejtë. Myzaferi ishte i ulur pranë meje, prandaj ishte detyra ime që atë të mos e zinte gjumi. Provova shumë metoda për ta lënë pa gjumë por mënyra më e efektive ishte ajo me përrallat meksikane.

Unë u mërzita duke i treguar gjithmonë të njëjtat përralla, por ai nuk lodhej së dëgjuari të njëjtat gjëra. Gjatë gjithë kohës më thoshte:

-Hajde m'i trego!

Nëse nuk do ia tregoja, ai do të flinte... Më në fund edhe Myzoja u bë si unë, llafazan i vërtetë. Por ç'faj kisha unë, a nuk ishte vetë mësuesi që ma kërkoi një gjë të tillë... Pastaj a nuk e di ai se Myzoja ishte gati për t'u bërë llafazan.

A nuk është kështu?

"Po!"

Ju falënderoj. Ju mjaftoi vetëm një fjalë për të shpjeguar gjithçka.

Të dashur shokë,

Unë nuk e di sesi është gjendja në klasën tuaj por tek ne kemi të gjitha tipat e nxënësve. Ju lutem, ju mos më shikoni mua se do të bëheni llafazan si unë.

NËSE DËSHIRON TË FRYSH, FRYJ NGADALË NËSE DO TA FLASËSH PAK, FOL RADHË!

Flitni pak dhe saktë. Përdorni fjalë të cilat mund të kuptohen nga të gjithë ata që ju dëgjojnë. Edhe nënat kur na kanë mësuar të flasim nuk kanë përdorur fjalë të tepërta. Ja po ju jap disa shembuj:

Na thanë: "shshsht" dhe ne e kuptuam rrezikun. Ne nuk kishim nevojë për shumë fjalë, na mjaftonte një "shshsht" e shkurtër për të kuptuar shumë gjëra...

Na thanë "zemër" dhe na dhuruan të gjithë dashurinë që kishin në shpirt.

Na thanë "xix" dhe ne nuk e prekëm...

Unë mund të jap edhe shumë shembuj të tjerë, por kam frikë se do të më quajnë përsëri llafazan. E di që nuk është mirë që ta ndërpres fjalën kështu në mes, por përsëri, njëri më ka drejtuar gishtin tregues dhe po më kërcënon!..

Mbetshi me shëndet, miq të dashur!

Të lumtë, gomar!

Një gomar kishte shërbyer për një kohë të gjatë në një çiflig, kishte marrë shumë përvojë, por ishte mërzitur nga jeta që bënte. Për këtë arsye u largua pa menduar fare duke thënë: "Tashmë nuk ka ngelur punë për mua në këtë çiflig".

La shumë kujtime të jetuara në këtë çiflig, por sidoqoftë përpara kishte një botë të tërë ku mund të jetonte çaste më të bukura. Prandaj gomari filloi të ecte drejt asaj bote. Ndërsa ecte, patkonjtë i kërcitnin "Traktruk!". Kjo botë e re nuk ishte mësuar me zhurmën e këtyre patkonjve. Andaj në një kohë të shkurtër zhurma e tyre tërhoqi dy miq që gomari i shikonte për herë të parë. Ai i pyeti se si quheshin... Njëri tha "Ujk", ndërsa tjetra "Dhelpër".

-Sa emra të bukur paskeni! - tha gomari. – Edhe gjuhën të ëmbël e paskeni, po aq sa dhe emrat!

Kështu ujku dhe dhelpra u afruan edhe më shumë me gomarin. Që të dy dëshironin ta hanin atë. Kërkuan ndonjë mundësi për ta ngrënë, nganjëherë edhe e lëpinë për t'i parë shijen... Por prisnin... Madje pati raste që edhe i hodhën nga një të kafshuar të lehtë. E. gomari mendoi se këto ishin lojëra dhe u besoi miqve dinakë.

Tani jeta e gomarit ishte çdo çast në rrezik, por ai rendte pas argëtimit. Kishin ardhur në një vend krejt të zbrazët. Më në fund, dhelpra dhe ujku e bënë të qartë qëllimin e tyre:

-Mos na e bëj më të vështirë tani planin tonë, gomar, eja, duam të të hamë!

Në atë çast pas shkurreve u dëgjua një ulërimë luani.

-Kush është ky? - pyeti gomari.

-Këtij i thonë luan. Ky i ha të gjitha kafshët!

Gomari vrapoi menjëherë te luani dhe i tha:

-Më shpëto nga dhelpra dhe ujku!

-Do të të shpëtoj! - i tha luani. – Por së pari kam një kusht. Pasi të të shpëtoj prej tyre, do të të ha dhe ty.

-Nuk ia tregoj dot askujt unë këtë ndodhi. Ushqimi i kujt të bëhem aspak nuk e di!

-Ashtu është mik, por duhet ta dish. "Më hëngri luani!" të thuash është më mirë dhjetë fish.

Gomari uli kokën, e hëngri ky luan, por askush nuk i tha "Të lumtë, gomar!"

Pekmezi

NJË ËMBËLSIRË NATYRALE

Nagehan Ynly

Në ditët e ftohta të dimrit gjithmonë dëshirojmë të hamë ose të pimë diçka të ngrohtë. Pekmezi është ushqimi më natyral që mund të na e plotësojë këtë nevojë. Ai është një shurup i ëmbël dhe i trashë, ëmbëlsirë që formohet nga shtrydhja dhe zierja e frutave të ëmbla si rrushi ose mani.

Pekmezi prodhohet nga një proces i gjatë dhe i vështirë punësh. Rrushi që përdoret për pekmez shtrydhet në forma të ndryshme si natyrale ose me makineri dhe i nxirret lëngu. Kjo shirë rrushi e thartë zihet për 10-15 minuta në 50-60 gradë brenda së cilës hedhim një pluhur të veçantë pekmezi. Ky pluhur i bardhë duhet t'i hidhet rrushit para se ta shtrydhim. Ky proces quhet 'prerje'. Me procesin e hedhjes së këtij pluhuri arrihet pastrimi i shirës, formohen fundërrinat që bien në fund të enës dhe hiqet thartësira që vjen nga rrushi. Pa këtë pluhur pekmezi bëhet i thartë dhe i turbullt.

Kur zihet pekmezi, heqja e shkumës që formohet sipër, bën që ai të duket më i qartë. Në këtë mënyrë, përftojmë një pekmez më të shijshëm. Shira e rrushit lihet në enë 45-55 orë. Përgjatë kësaj kohe, pjesët e mbetura që formohen nga copëzat që gjenden brenda këtij pluhuri të hedhur në fund të enës dhe shirës së rrushit, bien në fund. Pjesën e sipërme dhe transparente të shirës së rrushit e ndajmë nga pjesët e mbetura. Pastaj ato hidhen. Shira transparente që u nda, hidhet në enët e valimit të shirës.

Procesi që i jep pekmezit ngjyrën e errët dhe trashësinë është vlimi. Sheqeri në shira karamelizohet dhe nxihet përgjatë procesit të valimit. Ngaqë lëngu pakësohet përgjatë procesit të valimit, përzierja fillon e trashet. Valimi i kësaj përzierje dhe përhapja e erës së pekmezit, tregon se pekmezi ka marrë trashësinë e duhur.

Edhe pse vlerat ushqyese të pekmezit shfaqin rezultate të ndryshme sipas frutave me të cilat janë bërë, ai është një burim i mirë energjie në sajë të karbohidrateve që përmban. Pekmezi përmban vitaminat B1, B2 dhe lëndë minerale të ndryshme. Fakti që tetëdhjetë për qind e karbohidrateve që përmban gjendet në gjendje glukoze dhe fruktoze, mundëson kalimin e lehtë në gjak pa pasur nevojë që të copëtohen në sistemin tretës.

Pekmezi është një burim i mirë energjie në sajë të përmbajtjes së lartë të sheqerit. Përveç të gjithash, përmban shumë minerale. Pekmezi veçanërisht plotëson një pjesë të madhe të nevojës ditore të kalciumit, hekurit, kaliumit dhe magnezit. Pekmezi përdoret edhe për shtimin e gjakut në trup.

Pekmezi është disa llojesh, si: pekmezi i rrushit, pekmezi i manit dhe pekmezi i xhixhibanozit. Pekmezi përshtatet shumë mirë me tahinin. Veçanërisht në muajt e dimrit, konsumimi i pekmezit me tahinin na japin energji dhe na falin një imunitet më rezistues karshi të ftohtit.

DEA DHE FLUTURA

Elif Jemenxhi

Në një ditë të nxehtë vere, Dea doli në fusha të mblidhte lule.

Eci sa eci duke lodruar e kërcyer dhe më pas u shtri e lodhur nën hijen e një peme duke menduar e përgjumur mbi natyrën e bukur.

Në ëndërr pa një flutur shumë të bukur ngjyra-ngjyra. Nga krahët e fluturës binin yje. Ajo këndonte e vallëzonte pa ndalur. Dea shikonte e habitur vallëzimin e fluturës dhe dëgjonte këngën e saj.

Kur u zgjua, flutura e vogël kishte ikur. Kur e kuptoi se e gjitha kjo kishte qenë vetëm një ëndërr, Dea u mërzit shumë dhe shkoi drejt e në shtëpi.

"Sikur të kisha një shoqe të vërtetë flutur." - mendoi ajo. Kur arriti në shtëpi, u shtri të flinte për ta parë fluturën sërish në ëndrrat e saj.

Sapo e zuri gjumi, Dea pa sërish në ëndërr fluturën e vogël. “Të lutem flutur e bukur”, - i tha ajo fluturës, - “Eja të bëhemi shoqe! Të lodrojmë e këndojmë së bashku!”

Të nesërmen në mëngjes, ndërsa po shkonte në shkollë, Dea pa diçka që e habiti. Flutura jonë e vogël qëndronte gjallërueshëm mbi një luledele!



Dea fluturoi nga gëzimi dhe u afrua të lodronte me fluturën. Por çdo gjë ndryshoi kur të gjitha shoqet u habitën nga bukuria e fluturës dhe u afruan të lodronin me të.

Por Dea nuk donte ta ndante me askënd fluturën e saj të vogël. Ajo filloi t’u bërtiste shoqeve: “Është flutura ime ajo, nuk mund të luani me të!”

Pas kësaj fluturza u largua në fluturim. Për ditë të tëra Dea nuk e pa fluturën, madje as në ëndrrat e saj. E kuptoi veprimin e saj egoist dhe u pendua shumë për këtë, por ky pendim nuk kishte më vlerë, sepse flutura kishte ikur...

Pas disa ditësh Dea doli përsëri në fusha për të mbledhur lule. Pasi u ul dhe e zuri gjumi përsëri nën të njëjtën pemë, flutura erdhi duke fluturuar dhe qëndroi mbi hundën e saj.

Kur e pa, Dea fluturoi nga gëzimi. Thirri menjëherë shoqet e saj dhe lodruan së bashku me fluturën deri në mbrëmje. Tashmë Dea e kishte kuptuar se, t’i ndaje gjërat me të tjerët, ishte diçka e bukur.

Shporta e Semrës

Gylnihal Javuz

Semra ishte nëntë vjeçe. Atë ditë erdhi nga shkolla dhe pasi lodroi pak me shoqet, kërkoi të shkonte dhe të shikonte fqinjën e tyre, teto Lejlën që Semra e donte shumë. Edhe teto Lejla e donte shumë Semrën dhe kalonin shumë këndshëm së bashku. Ajo e qerasi përsëri Semrën me karamelet e saj ngjyra-ngjyra, që dukeshin shumë të bukura dhe të shijshme.



Semra e mori karamelen dhe nga dëshira e madhe për ta shijuar, e futi menjëherë në gojë, por sapo filloi ta përtypte me dhëmbë, ndjeu një dhimbje dhëmbi që e shqetësoi shumë. Kur erdhi në shtëpi, dhimbja e dhëmbit iu shtua edhe më shumë. Ditët e fundit kishte kuptuar se sa herë që hante ëmbëlsira, i ndodhte e njëjta gjë. Dhimbja e dhëmbit e bënte Semrën të mos e zinte vendi.

Kërkoi të shtrihej dhe të priste që dhimbja t'i kalonte. Sapo mbylli sytë, në mendje i erdhi videoja që kishte ndjekur dje me nënën. Nëna e kishte regjistruar me videokamer kur ajo ishte bebe dhe sapo i kishin dalë dhëmbët e parë. Dalja e dhëmbëve nuk ishte diçka e lehtë. Madje, ndonjëherë shkaktonte edhe temperaturë te bebet.

Mendoi për të gjitha sakrificat që nëna e saj kishte kaluar për secilin dhëmb që i kishte dalë asaj dhe për të gjitha lojërat që kishte improvizuar vetëm e vetëm që ta mësonte të përdorte furçën. Kur Semrës i kishte dalë dhëmbi i parë, nëna e saj kishte ftuar të afërmit dhe i kishte qerasur me një ëmbëlsirë të lehtë që e kishte bërë me grurë. Ky ishte një zakon i cili quhej "dita e grurit të dhëmbit".

Videoja e djeshme tregonte pikërisht këtë ditë. Nëna kishte përgatitur për të një shportë të bukur dhe brenda kishte futur biskota të bëra në formë dhëmbi. Pastaj me atë shportë kishte qerasur mysafirët. Të gjithë luteshin. Të gjithë e kishin marrë në krahë duke u lutur për të. Gjyshi kishte bërë këtë lutje: "Allahu i mundësoftë që me këta dhëmbë të hajë vetëm hallall!", ndërsa babai: "Lus Allahun, që dhëmbët të mos i prishen kurrë!".

Në lidhje me këtë çështje, nëna e saj ishte shumë e ndjeshme. Që në foshnjëri dhe kur filloi të shkonte në shkollë, nuk i jepte Semrës shumë ushqime me sheqer. Edhe nëse hante, mundohej që t'ia lante dhëmbët menjëherë. Gjithashtu e inkurajonte atë të përdorte misvak ngaqë ishte edhe synet i Pejgamberit tonë të dashur (s.a.s.).

Ndërsa i mendonte këto, Semra filloi të qante. Dhimbja e dhëmbit sa vinte e shtohej dhe ishte bërë e padurueshme. Nëna dëgjoi zërin Semrës që po qante dhe hyri menjëherë në dhomë. Kur mësoi se i dhembte dhëmbi, u mërzit shumë. Ajo e përqafoi vajzën duke i thënë se do t'i kalonte, pastaj i telefonoi dentistit dhe la një takim me të.

Të nesërmen kur shkuan te dentisti dhe po hynin në klinikë, Semra ishte e shqetësuar. U frikësua kur hyri në dhomën ku ndodheshin makineritë e mëdha. Dentisti i priti me shumë mirësjellje. Pastaj e uli Semrën në kolltuk për ta vizituar. Ndërkohë Semra ia kishte kapur dorën nënës dhe po ia shtrëngonte fort. Teksa po i kontrollonte dhëmbët, dentisti mbante në dorë një mjet që ngjante me një grep. Me këtë mjet kontrollonte dhëmbët e prishur. Doktori i tha Semrës se dhëmbët e saj dukeshin shumë mirë. Ishte vetëm një prishje e vogël ajo që e shqetësonte. I tha gjithashtu se do ta pastronte dhe do të vendoste një mbushje, e cila do ta mbronte dhëmbin që të mos prishej edhe më shumë. Folën edhe për shkakun pse prisheshin dhëmbët.

Semra i tha xhaxhi dentistit se kohët e fundit kishte ngrënë shumë karamele dhe çokollata në shkollë dhe se nuk i kishte larë sa duhej dhëmbët. Dentisti e këshilloi Semrën të mos e linte pas dore larjen e dhëmbëve. Nëse kujdesej për to, do t'i kishte më të shëndetshëm.

Gjatë bisedës Semra ishte qetësuar. Ajo u gëzua shumë kur dentisti i tha "Dhëmbët duken shumë mirë!". Tani vendosi që të kujdesej më shumë për ta. Para se të nisej për në shtëpi ajo i tha dentistit se pas gjashtë muajsh do të vinte sërish për kontroll edhe nëse dhëmbi nuk do t'i dhembte. Pas kësaj vizite të gjithë ishin të lumtur.

MENDO PAK... E BUZËQESH

Abdullah Thaçi

Rri si mushka përmbi lumë,
nuk pi ujë as nuk bëj gjumë?

(Ura)

Pak dhunti, pak trashëgim,
më shumë punë e kultivim?

(Talenti)

Herë të prin, herë të ndjek,
kur s'ka diell zhduket krejt?

(Hija)

Cili jorgan sipër nesh,
arnohet me arna resh?

(qielli)

Bardh' e verdh' në të ndryhen,
gjë s'i ndan, por nuk
përzihen?

(Veza)

Hyn e del nga një shpellë,
për kovaçët shkarkon gjellë?

(Iuga)

Veshë të gjatë, këmbë të lehta,
fort e ëmbël, vëllaçko, jeta?

(Iepuri)

Çfarë Si PERSE?

Zehra Aksoy

Si funksionojnë furrat me mikrovalë?

Në furrat normale nxehtësia, së pari, bie në kontakt me enën e ushqimit, më pas me pjesën e jashtme të ushqimit dhe në këtë mënyrë fillon e depërton në brendësi të tij. Mikrovalët që përdoren në një furrë, pra mikrovalët që dërgohen mbi ushqim janë në përmasat e valëve të radios me frekuencë 2500 mhz; kjo përafërsisht është sa 20 fishi i frekuencës së radios në FM. Valët në këtë frekuencë kanë karakteristikë të veçantë: lëndët plastike, të qelqit dhe qeramike të cilat përthithin lehtë ujin, sheqerin dhe vajin, në këtë rast nuk i përthithin më dhe i kthejnë pas. Në mikrovalë dallgët depërtojnë drejtpërdrejtë në ushqim dhe ndikojnë në molekulat e ujit dhe të vajit. Pra nuk bëhet fjalë për një nxehje të ushqimit duke filluar nga jashtë-brenda, ose në drejtim të kundërt. Për shkak se molekulat e ujit dhe të vajit përhapen në të gjithë ushqimin, ngrohja e tij bëhet e njëjtë në të gjitha anët.

Si shkruan stilolapsi?

Stilolapsi përmban një tub të mbushur plot me bojë, në majën e të cilit është i montuar një topth. Ky topth qëndron i vendosur mirë në majën e stilolapsit. Ai lejon aq rrjedhje boje sa duhet për të shkruar mbi letër. Ndërsa stilolapsi lëviz mbi letër, topthi rrotullohet brenda zgavrës së tij. Me anë të këtij rrotullimi merr me vete bojën nga tubi dhe e mbart mbi letër. Në këtë mënyrë realizon shkrimin. Boja e stilolapsit ndryshon nga ajo e stilografit. Kjo bojë është me përmbajtje më të trashë, me ngjyrosje më të fortë, lubrifikante, më të errët dhe më të thatë.

Si formohet perla?

Perlat prodhohen nga guaskat. Lëvozhga e jashtme e saj, e cila është shumë e vështirë për t'u hapur, është e mbështjellë me karbonat kalciumi. Guaskat shqetësohen kur brenda tyre hyn rërë, zhavorr ose organizma parazitarë që i dëmtojnë. Kështu, për t'u mbrojtur nga këto gjendje fillojnë të mbështillen nga një shtresë sedefi. Në këtë mënyrë formohet perla.

Bima e shkretëtirës

KAKTUSI

Mete Ullusoj

Kaktusi është një bimë me trung të trashë, të rrafshët, me përmbajtje uji, me gjethe në formë gjembash. Zakonisht rritet në shkretëtira dhe vendet tropikale.

Nëse ushqehet mirë, gjatësia dhe gjerësia e kaktusit bëhet mjaft e madhe. Disa kaktuse i kanë gjembat helmues, por ndonëse mund të mos i kenë të tillë, nëse të ngulen në lëkurë, shkaktojnë shumë dhimbje dhe është e vështirë t'i heqësh.

Kaktuset janë bimë që nuk kërkojnë shumë ujë dhe rreshje. Gjenden pothuajse 1800-2000 lloje të tyre. Kanë rrënjë shumë të gjata dhe të trasha. Këto veçori dhe fakti se i kanë gjethet në formë gjembash, i bën ato të ndryshme nga bimët e tjera.

Bimët e thatësirës mund t'i rezistojnë çdo lloj kushti klimatik dhe mund të japin fara në çdo stinë të vitit. Gjethet në formë gjembash janë të vendosura me një gjeometri të caktuar në trungun e mishtë të kaktusit.

Familja e kaktusit posedon një sistem me të gjitha karakteristikat për të përballuar kushte të vështira klimatike. Në sajë të këtij sistemi nuk shkon dëm as edhe një pikë ujë.

Siç dihet, në zonat e thata rreshjet e shiut janë të rralla, por vesa dhe mjegulla shihen shpesh. Kështu kaktusët, para se mjegulla të shpërndahet dhe të fillojë avullimi, për të marrë ujin e vesës dhe të mjegullës përdorin sythat e vegjël që ndodhen në fund të trungut dhe që funksionojnë tamam si sfungjerë. Uji që thithet nga sythat sfungjeror përçohet në të gjitha indet e kaktusit.

Por kaktuset nuk e sigurojnë ujin vetëm nga këta sytha sfungjeror. Ata e marrin ujin e nevojshëm nga toka me anë të një sistemi të veçantë pompues. E arrijnë ujin në thellësi të tokës me rrënjët e tyre mjaft të gjata. Rrënjët e një kaktusi me gjatësi jo më shumë se 50 cm, mund të shkojnë deri në 18 m thellë në tokë dhe përhapen në një sipërfaqe prej 12 metrash.

Uji i shiut ose vesa pompohet nga rrënjët e kaktusit ose përthithet nga sythat e vegjël që gjenden në pjesën e fundit të tij. Në këtë fazë uji e shton me pothuajse 75% peshën e kaktusit, ndërsa gjatë stinës së thatësirës ai humb afërsisht 70% të peshës.

Një lloj kaktusi nuk e ka të mundur ta depozitojë dhe ta mbajë gjatë ujin. Ai nuk duhet ta harxhojë ujin e depozituar me djersitje. Për këtë arsye disa lloje kaktusi që kanë gjethe shumë të vogla, djersisin sa 1/30 e një peme me gjethe normale dhe në këtë mënyrë humbasin 30 herë më pak ujë.

Një nga llojet e kaktusit që quhet “kaktusi qiri”, mund të depozitojë brenda qelizave të degëve përafërsisht 5-10 ton ujë. Edhe rrënjët në njërën anë kryejnë detyrën e depozitimit të ujit, në anën tjetër me anë të veprimit të tkurrjes dhe bymimit tërheqin brenda tokës bimën duke e mbrojtur në këtë mënyrë nga rrezet e diellit.

Kaktuset, përveç se plotësojnë nevojën e tyre të ujit duke e depozituar atë, në të njëjtën kohë u vijnë në ndihmë edhe njerëzve të shkretëtirës të cilët në mungesë të ujit rrezikojnë të vdesin. Për shembull, në shkretëtirën Arizona në Amerikë, zonat ku ndodhen kaktusët gjigantë ngjajnë me një oaz të vërtetë.

Tregimi i Djalit me kalë

Ahmet Efe

"O Zot!", thirri ai. "Shiko sa i bukur qenka ky kalë! Krejt i bardhë. Mbi të gjitha paska edhe krahë!"

"Prit!", i tha pastaj. "Prit, do të hip sipër teje!"

Kali ndaloi, zgjati krahët dhe djali hipi menjëherë mbi shpinën e tij. "Tani vrapo sa të kesh fuqi!", tha djali. "As era mos të të kapë!"

Kali i bardhë hingëlliu i ngazëllyer, u hodh mbi këmbët e para dhe fluturoi si një shigjetë. Flokët e fëmijës fluturonin, po ashtu edhe krifa e kalit; flokët e fëmijës bashkoheshin me krifën e kalit. Të gjithë i ndiqnin me admirim: dielli, zogjtë dhe të tjerët...

Gjendja e tyre ngjante me fjalën e urtë "Kali hingëllin sipas të zotit." Edhe këtij kali të bardhë i pëlqeu aq shumë djali guximtar që qëndronte mbi shpinën e tij, saqë e fluturoi atë mbi luginat pa mbarim.

Kaluan lumenj të rrëmbyeshëm e me shkumë.

"Më ço në malin Kaf!", i tha djali.

Sa hap e mbyll sytë arritën në malin Kaf. "Më prit këtu!", i tha ai; pastaj zbriti nga kali i bardhë dhe shkoi drejt pallatit të mbretëreshës së zanave. Rojat e hapën pakëz derën. Djali ngjiti nxitimthi shkallët, kaloi sallonet dhe më në fund arriti në dhomën e madhe dhe të shëndritshme të pritjes, e cila kishte një kupolë madhështore. Mbretëresha e zanave ishte ulur

në fronin e saj të artë dhe po e priste.

"Mos vallë ka ndodhur përsëri ndonjë problem?", e pyeti ajo.

Djali uli kokën dhe tha: "Po." –"A rrihet njeriu se humbi një dele?"

"Prit!", i tha mbretëresha e zanave. "Do të të jap një ilaç për plagët, por për plagën e zemrës nuk kam ilaç..."

"Më thyen zemrën", tha djali. "Më rrahën për shkak se ujku më hëngri një qengj. Po të kisha babain, nuk do të mund të më godisnin. Po të kisha nënën, nuk do të më kishte lënë të qaja..."

"Unë njoh shumë fëmijë që u kanë vdekur prindërit", i tha mbretëresha e zanave. "Ata kanë korrur shumë fitore. Duhet të dish të durosh dhe të kthehesh nga erdhe."

Djali u kthye pas. Doli nga dera. Kali i bardhë po e priste para portës. Hipi në shpinën e tij dhe shkoi fluturimthi në shtëpi. Njerku bërtiste përpara derës së ahurit me një shkop të madh në dorë: "Zbrit nga çatia, Omer! Ke dy orë që fle në të nxehtë. Do të të dëmtojë gjithë ai diell..."

FABULA NGA EZOPI

1.

DHELPRA DHE LUANI

Një dhelpër pa një luan të mbyllur në kafaz dhe kur qëndroi pranë tij, filloi ta shante rëndë. Dhe luani i tha: "Nuk më shan ti, por fatkeqësia që ra mbi kokën time."

2.

QENTË DHE DHELPRA

Disa qen gjetën lëkurën e një luani dhe e tërhiqnin duke e shqyer me dhëmbë. Dikush i pa, u tha: "Po të ishte gjallë ky luan, do të shihnit se kthetrat e tij janë më të fortë se dhëmbët tuaj."

3.

MAÇOKU I EGËR DHE ZOGJTË

Një maçok i egër u shti sikur kishte ditëlindjen dhe ftoi për drekë disa zogj. Pastaj, duke marrë masa që të hynin të gjithë brenda, mbylli dyert dhe filloi t'i hante njëri pas tjetrit.

4.

DRUVARËT DHE LISI

Disa druvarë po çanin një lis duke përdorur pyka që bëheshin prej tij. Dhe lisi u tha: "Nuk akuzoj aq sëpatën, e cila më preu, sesa pykat që u bënë prej meje."

SUPER ZBAVITJE

Nëse i vendosni numrat që janë poshtë tabelës nga e majta në të djathtë dhe nga sipër poshtë, do të përftoni shumën 36. Gjejeni, pa humbur kohë...

9		5	10
	13		8
14			
8	7		3

18-10-3-4-15-5-12

SUDOKU

	9	7			8		4	
		3	9		4	6		
2	8						7	9
	4			3	5	7		
3		1	7					8
9		5	8	4		3		1
	2		4				3	
		9	3	8		2		5
7	3			6	2			4

Plotësoni çdo rresht, kolonë dhe kutizë, në mënyrë që, çdo shifër nga 1 deri te 9, të shfaqet një dhe vetëm një herë.

Gjej 7 ndryshimet!



Plotësoni vendet bosh
të figurës me alternativat që u janë dhënë.



Pula dëshiron të shkojë të ngrohë vezët e saj. Ajo nuk di cilën rrugë të zgjedhë. Gjeni rrugën e saktë...

LABIRINT



E zeza ndjell të zezën...

Një grua gatuante bukë çdo ditë. Dhembshuria e zemrës së saj, për të varfrit, e bënte të gatuante një simit më tepër. Simitin shtesë e vendoste te pragu i dritares. I varfëri kalimtar që vinte për të lypur derë më derë merrte simitin dhe thoshte me veten e tij: "E keqja mbetet tek ju, por edhe e mira ju kthehet." Gruaja nuk e pëlqente shprehjen e fukarasë, sepse nuk arrinte ta kuptonte. Ajo mendonte se kjo shprehje e fukarasë është sjellje mosmirënjohëse. "Ky gojëhelm, seç flet me veten." – thoshte gruaja me habi.

Ditët kalonin dhe fukaraja kishte të njëjtin avaz, merrte simitin dhe pëshpëriste: "E keqja mbetet tek ju, por edhe e mira ju kthehet."

Gruaja e mërzitur nga vetmia, e shqetësuar për djalin e saj që ishte larguar nga shtëpia në kërkim të një jete më të mirë, e inatosur nga mosmirënjohja e fukarasë vendosi ta heq qafe atë një herë e mirë. Gatoi një simit me helm dhe e vuri në prag të dritares. Fukaraja i mjerë, i paditur me qëllimet dhe veprimet e gruas merr simitin dhe pëshpërit fjalën e tij… Gruaja, e cila vështronte pas perdes, thotë: "Një telashe më pak."

Diku nga dreka, i troket dera e shtëpisë. "Vallë, kush do të jetë?" – pyet veten gruaja e vetmuar. Ngrihet nga kolltuku, hap derën dhe lotët e gëzimit i fillojnë t'i rrjedhin. Djali u kthye në shtëpi. Dukej shumë i lodhur nga rruga dhe ishte i zbehur në fytyrë.

- Djali i nënës, sa vite u bënë pa të parë?

- Dhjetë vite, nënë e shtrenjtë.

- Të shoh shumë të lodhur. Ke bërë rrugë të gjatë?..

- Po, shumë të gjatë, për më tepër uria më griu gjithë rrugën. Në hyrje të qytetit e theva urinë me simitin e një plaku të gjorë…

- Ç… fa… rë?!.. Si… mitin e një pla… ku? Ku …? Kur …? Si …?!

- Po nënë. Isha shumë i uritur. Plaku më pa të tretur nga fytyra dhe më ofroi torbën e tij.

- E mjera unë! Më gjeti e keqja e duarve të mia…

Vetëm atëherë gruaja e kuptoi shprehjen e urtë të plakut fukara: "E keqja mbetet tek ju, por edhe e mira ju kthehet."

Përgatiti: Gilman Kazazi

Lagjja Jonë

Ç'ka ndodhur gjysh, mos je gjë sëmurë? Të të jap një ilaç dhe do të bëhesh më mirë.
Më jep më mirë një kilogram oriz, do të më bënte më mirë.
Zonja Shemsije, edhe ti je e sëmurë? Të të jap ty një ilaç që të bëhesh më mirë...
Më jep një kilogram sheqer se do të më bëjë më mirë.
Ou! Lypës, edhe ti je i sëmurë? Të të jap ty një ilaç që të bëhesh më mirë...
Për Zotin, more dyqanxhi efendi, ti më jep një pako biskota, them se do të më bëjnë më mirë.
Oo! Verdhacuk! Domethënë edhe ti je i sëmurë. Edhe ty një çokollatë do të të bënte mirë...
Nuk dua xhaxhi dyqanxhi... Më jep ilaç po pate...
Ja pra, ky është i sëmuri i vërtetë.

Tani në dorën tuaj...

i gjeni pranë shtëpisë botuese "Progresi"